

Formulari – F3



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I INXHNIERISË MEKANIKE

Rruga Agim Ramadani, Ndertesa e Fakulteteve Teknike, 10 000 Prishtine, Republika e Kosoves
Tel: +383 38 552 126 ext. 101 * E-mail: fim@uni-pr.edu * www.fim.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 205
Datë: 04/02/2025

**RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË
DIPLOMËS MASTER**

FAKULTETI	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti/Programi	Departamenti i Komunikacionit / Komunikacion rrugor
Titulli i punimit	“PLANI I MOBILITETIT TË QËNDRUESHËM PËR TRAFIKUN E MOTORIZUAR DHE PAMOTORIZUAR NË QYTETIN E FERIZAJIT” “Sustainable urban mobility plan for motorized and unmotorized traffic in Ferizaj city”
Kandidati	Bsc. Trimor Rexhepi
Mentori	Prof. ass.dr. Gëzim Hoxha
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 02.05.2024 Vendimi Nr.: 632/3-5

Konkluzion


Punimi i masterit me titull “PLANI I MOBILITETIT TË QËNDRUESHËM PËR TRAFIKUN E MOTORIZUAR DHE PAMOTORIZUAR NË QYTETIN E FERIZAJIT”, i kandidatit BSc. Trimor Rexhepi, i përbush parakushtet metodologjike, profesionale-shkencore dhe etike të një punimi të nivelit Master. Punimit i është bashkëngjitur edhe Deklarata e studentit për punë autentike. Prandaj, në mbështetje të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe në mbështetje të Rregullores për studime Master, Komisioni për vlerësim, unanimsisht dhe me kënaqësi i:

Propozon

Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, të miratojë Raportin për vlerësimin e punimit për Master me titull “PLANI I MOBILITETIT TË QËNDRUESHËM PËR TRAFIKUN E MOTORIZUAR DHE PAMOTORIZUAR NË QYTETIN E FERIZAJIT”, i kandidatit BSc. Trimor Rexhepi, dhe të bëjë procedimin e mëtejshëm, përkatësisht të formojë Komisionin për mbrojtje dhe të caktojë datën për mbrojtje publike të punimit.

Prishtinë: 31/01/2025

Komisioni:

1. Prof. asoc. dr. Ramadan Mazrekaj  - kryetar

2. Prof. ass. dr. Gëzim Hoxha  -mentor, anëtar

3. Prof. ass. dr. Arlinda Rrecaj  - anëtar

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.

ABSTRAKTI

Punimi i diplomës synon të adresojë problematikën e lëvizshmërisë urbane, gjegjësisht trafikut të motorizuar dhe pamotorizuar në qytetin e Ferizajt në mënyrë që të ofrohet zgjidhje e qëndrueshme për lëvizshmërinë urbane.

Duke njohur problematikën e lëvizshmërisë dhe jetës urbane në qytetin e Ferizajt, konsiderohet se mënyra e organizimit të lëvizjeve ka rol të veçantë në siguri rrugore, efikasitet, mjedis si dhe në cilësinë e jetës së qytetareve.

Zhvillim i koncepteve, përzgjedhja e skenarëve të duhur të organizimit të trafikut dhe aplikimi i tyre ka ndikim të madh në cilësinë e lëvizjeve të ofruar në zonat e qytetit.

Problematikat që shfaqen në lëvizshmëri urbane shpeshherë janë rezultat i mungesës së definimit të skenarëve të trafikut të cilët do të përdoren ose zgjedhja e skenarëve pa analizuar mirë nevojat dhe cili është skenari më i përshtatshëm. Për të adresuar problemet e lëvizshmërisë, në punim identifikohen faktorët kryesorë që kanë ndikim në krijimin e problemeve të qarkullimit dhe format më të përshtatshme të zgjidhjeve dhe masave konkrete, duke bërë mbledhje të dhënave reale dhe analizën e tyre.

Në këtë hulumtim është realizuar analizë në mbështetje të kërkesës reale për lëvizje si dhe zhvillimi i skenarëve të përshtatshëm për zgjidhjen e problemeve të trafikut të motorizuar dhe pamotorizuar përmes implementimit të masave adekuate në qytetin e Ferizajt. Për qëllime të përmbushjes së kërkesave hulumtuese të punimit, janë realizuar matje të qarkullimit të motorizuar dhe të pamotorizuar, janë përdorur për referencë analiza dhe praktika nga vendet e tjera si dhe janë analizuar mundësitë e përshtatjes së këtyre praktikave me nevojat e qytetit të Ferizajt. Kjo punë synon të ofrojë një kontribut në fushën e organizimit të trafikut të motorizuar dhe pamotorizuar në zonat urbane duke përdorur analizë të dhënave reale dhe krahasim të skenarëve të zhvilluar, për të arritur zgjidhjen më të përshtatshme dhe lëvizshmëri të qëndrueshme në zonën urbane.